



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.
2. Miratimi i draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të INSTAT-it për vitin 2021.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Benet Beci, Dashamir Shehi,

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Alfred Rushaj, Agron Shehaj.

Të ftuar

Elva Margariti – Ministre e Kulturës

Entela Cipa – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Kozeta Angjeliu – Drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve për Zhvillimin e Kulturës në Ministrinë e Kulturës

Martin Mata – Drejtor i Ekzekutiv i AADF-së

Aleksandër Sarapuli – Drejtor i Përgjithshëm i AADF-së

Illir Parangoni – Menaxher Projekti për Kulturën dhe Ekoturizmin, AADF

Ekflodia Leskaj – Këshilltare Ligjore, AADF

Luan Përzhita – Drejtor i Institutit të Studimeve Albanologjike

Belisa Muka – Drejtoreshë e Institutit të Arkeologjisë

Gentian Opre – Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Vilma Çauholli – Përgjegjës Sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBPEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje!

Mirëmëngjesi!

Me një pjesë të deputetëve u takuam që në orën 8:30. Për të gjithë ato që na ndjekin, ne kemi filluar një debat të zjarrtë prej disa minutash në lidhje me çështjen e Butrintit.

Zonja Ministre, mirë se erdhët në komision!

Sot kemi seancën e përgjigjeve të pyetjeve që kolegët kanë bërë. Besoj janë zbardhur të gjitha pyetjet.

Patëm një dëgjese shumë interesante me një grup studentësh që në orën 8:30 të mëngjesit dhe në finale do ta zbardhim atë që prezantuan dhe do t'ua vëmë në dispozicion. Kanë një merak, se duan të përfshihen më shumë në çështjen e Butrintit, duke e parë si mundësi shumë të mirë për shkak të historisë së Butrintit, asaj që përfaqëson ky sit i mrekullueshëm arkeologjik i vlerësuar edhe nga trashëgimia botërore.

Do t'ju vëmë në dispozicion edhe prezantimin që ato bënë. Ato kanë ndjekur debatet, sidomos të dy javëve të fundit, një vështrim analitik tq asaj çka thuhet në medie dhe çfarë është e shkruar nëpër letra.

Pa humbur kohë, do të doja t'i jap fjalën ministres.

Më falni, zoti Agalliu, për procedurë.

Arbi Agalliu – Faleminderit, kryetar!

Së pari, unë e vlerësoj prezantimin që bënë studentët. Sikurse edhe kolegu Shehu e përmendi, është mënyrë alternative apo informacion alternativ, i cili na sjell një informacion në një këndvështrim tjetër.

Si komision, besoj se gjithë kolegët janë të hapur për të marrë informacione në mënyrë alternative, gjë që jep një lloj mundësie për të pasur një vendimmarrje sa më të saktë.

Nga ana tjetër, zoti kryetar, realisht ndihem keq kur diskutoni përmendni faktin e prezantimit të studentëve sikur zgjidh çdo gjë.

Po të jap një informacion shumë të thjeshtë, së paku këtu, duke filluar nga kolegja Koti, ka minimalisht 14 vjet pa shkëputje në mësimdhënie, kolegja Zhupa ka 10 vjet, personalisht kam 15 vjet, pa shkëputje, e kështu me radhë, kështu që këtë impresionim apo ngritje në pedestal i

një prezantimi, unë do ta marr si ofendim për ne, sikur ne nuk dimë, nuk kemi informacion etj., etj., gjë që nuk shkon në një komision ekonomie.

Ne nuk jemi ekspertë të arkeologjisë, por ne po gjykojmë rentabilitetin e dhënies së këtij parku në këtë lloj forme nga pikëpamje ekonomike dhe patjetër që informacionet e arkeologjisë do t'i marrim nga ekspertët e arkeologjisë. Prandaj do të sugjeroja, shumë miqësisht, pasi vlerësimin për kryetar besoj se personalisht dhe nga kolegët e ke pasur si një kryetar konsensual dhe në përgjithësi luajal, të mos zgjatemi sikur kemi një orar për të nisur mbledhjen, sepse mua më duket sikur janë provokime, të cilat nxisin debat përtej thelbit të mbledhjes për të cilën ne jemi mbledhur.

Këtë shqetësim kisha dhe doja ta përcillja.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Meqenëse e hape këtë diskutim, në fakt, e meriton një përgjigje jo ju, por përgjithësisht tema, sepse kam parë që në emër të studentëve të flasim shumë njerëz, kam vënë re dhe kam konstatuar një hipokrizi të paparë, për hir të së vërtetës.

Unë nuk ngrita në pedestal një prezantim, thjesht solla në vëmendje. Nuk e kuptoj pse një pjesë juaja kompleksohen, ndërkohë që shpreha konsideratën time për një prezantim të 11 vetave që erdhën dhe prezantuan 3 veta, që kishin prej 2 javësh, ditë e natë, analizonin çfarë ishte thënë mediatikisht, kush e kishte thënë dhe kishin marrë përsipër të konspektonin planin e menaxhimit, kishin marrë përsipër të konspektonin çdolloj dokumenti që nga mënyra se si ishte anëtarësuar siti në trashëgiminë e UNESCO-s në '92-'93, firmëtarët e dokumenteve, arkeologët e shquar shqiptarë dhe disa kundërthënie, disa konfuzione të çështjeve, të cilat më shumë pretendonin të ngatërronin opinionin publik se sa synonin të qartësonin. Pra, është kaq e thjeshtë dhe mos u kompleksoni dhe mos u shqetësoni nga ajo që unë thashë! Dakord?

Unë për veten time vijoj të jem një nxënës i devotshëm dhe nuk kam kurrfarë kompleksi të mësoj nga studentët apo nga cilido. Pra, thjesht solla në vëmendje çfarë pashë në një orë e gjysmë dhe thashë opinionin tim, sikundër e kemi bërë edhe me një pjesë të profesorëve dhe doktorëve të nderuar që kanë ardhur në komision, sikur e kemi bërë me një pjesë të individëve të tjerë që kanë dashur të takonin individualisht dhe jo, në komision, sikundër disa nga kolegët e mi mësova se janë kontaktuar, janë parë, por mos u shqetësoni nga debati, mos u shqetësoni nga mënyra se si u qasemi gjërave!

Dëgjova herës tjetër që këto janë kinezëri, këto gjëra që po bëni na kujtojnë revolucionin kinez, ndërkohë që, kur studentët dalin të protestojnë, ne themi pse nuk i dëgjuam. Ndaj, mbani një qëndrim më konstant, se është një pjesë e njerëzve që kemi dëgjuar gjatë kësaj periudhë!

Kjo është e gjithë historia.

Për procedurë, zoti Spaho, zonja Gjylameti, zonja Zhupa dhe zonja Resulaj.

Edmond Spaho – Ju thatë se qeveria shqiptare, arkeologët shqiptarë, me firmë e me vulë e kanë paraqitur si qytetërim grek, kulturë greke...

Eduard Shalsi – Ju lutem shumë, ka një gjë shumë të madhe. Unë thashë që referohuni çfarë thotë, nuk thashë fare se e kanë paraqitur dhe si e kanë paraqitur. Unë thashë: Lexoni se çfarë shkruhet në sajtin e UNESCO-s mbi Butrintin! Kaq.

Edmond Spaho – Se çfarë shkruan UNESCO-ja, është puna e saj, se çfarë thotë qeveria shqiptare, është punë e qeverisë shqiptare.

Në lidhje me kulturën, mos harro që Butrinti është shtresëzim kulturash, fillon që nga periudha parahistorike, ka kulturë greke, ka kulturë romake. Mos e paraqit këtë si argument të qëndrimeve të gabuara të qeverisë! Se i bie pastaj që ato që janë ndërtuar në tokën turke, të jenë kulturë turke, në qoftë se shkojmë me këtë logjikë.

(Diskutime në sallë)

Blerina Gjylameti – Zoti kryetar,

Rregullisht në këtë komision kemi pasur debate për mosmarrjen e opinionëve apo konsultimeve në lidhje me projektligje të caktuara. Në momentin që e bëjmë kemi kontradikta pse e bëjmë, kemi pasur debate pse ministria nuk ulet me grupet e interesit, përse ministria nuk ulet me profesionistët. Vjen një projekt i konsultuar me mbi 80 veta, përsëri anatemohej. Kemi debate përse nuk i dëgjojmë profesorët. I thirrëm profesorët dhe i dëgjuam. Të njëjtën gjë bëjmë me studentët. Tani anatemojmë studentët.

Meqenëse po diskutojmë këtu dhe jemi një pjesë e mirë që vijmë nga fusha akademike, pjesës më të madhe nuk i lejohet të bëjë konstatime të tilla. Fakti që disa të rinj morën përsipër me fakte të treguar qëndrimet tona, në kontradiktë me atë çfarë është e vërteta, tregon se ata që na ndjekin, e bëjnë fare mirë gjykimin për çfarë bëjmë mirë dhe çfarë bëjmë keq, për çfarë flasim drejt dhe çfarë flasim jo drejt dhe në anën tjetër të bëhet kapital politik vazhdimisht për të pavërtetat, ka treguar që nuk e bën dot.

Unë shpresoj shumë që në këtë komision të ulemi të diskutojmë për atë çfarë i përket këtij komisioni. Të mos vijojmë të bëjmë ekspertët e fushës së arkeologjisë, se nuk jemi! Atë e kanë bërë profesorët përkatës, e kanë bërë profesionistë përkatës, janë konsultuar nga ministria, kemi arritur të kemi edhe grupe interesi, përtej asaj çfarë është konsultuar nga ministria. A mundemi të hyjmë në pjesën e diskutimit dhe të miratimit nen për nen të këtij projektligji? Besoj se në këtë mënyrë i shkojmë përshtat asaj çfarë është ky komision, i fokusuar tek eficientia, efektiviteti dhe mirëmenaxhimi i parasë publike.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zonja, zonja Zhupa!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, një minutë zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Meqenëse isha pjesë dhe i dëgjova komentet e studentëve, gjithashtu, kolegu Arbi i përmendi të gjitha vitet e eksperiencës që kemi në mësimdhënie, ne këtë e kemi sa të gjithë ata bashkë, është një gjë shumë e mirë që studentët marrin përsipër të sqarojnë opinionin publik me argumente dhe me njohuritë e tyre për atë që ndonjëherë edhe politika e ngatërrohet.

Unë do të dëshiroja të nxisja që për çështje, që lidhen drejtpërdrejt me Komisionin e Ekonomisë dhe me argumentet ekonomike, edhe studentë të fakulteteve të tjera, sidomos të Fakultetit të Ekonomisë, ndoshta edhe pedagogë, të bëhen pjesë e këtyre debateve dhe diskutimeve për t'i dhënë opinionin publik informacionin e duhur dhe të saktë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Resulaj!

Janë edhe dy kolegë të tjerë që e kanë bërë sugjerime për studentët. Jemi në kontakt me disa titullarë departamentesh, madje është një proces i nisur për këtë, kështu që do ta bëjmë.

Urdhëroni, zonja Zhupa!

Ina Zhupa – Faleminderit!

Së pari, për sa u përket studentëve, ju thatë se ishin studentë të arkeologjisë që kishin bërë një analizë të komunikimit. Analizën e komunikimit e bëjnë studentët e shkencave sociale ose të komunikimit dhe ata të arkeologjisë bëjnë analizën e pjesë së tyre, megjithatë e vlerësoj.

Seanca nuk ka qenë publike, dhe kjo më duket ka qenë zgjedhja e studentëve, në mos gaboj.

Sot, më 17 maj, ditën e ekzekutimit të Teatrit Kombëtar, unë dhe 7 kolegë në Komisionin e Edukimit kërkojmë një dëgjese për çështjen e Butrintit me Neritan Cekën, me Auron Taren, me Apolon Baçen, me Agron Alibalin, me Rudina Jasinin dhe me Giora Solarin. Duke qenë se maxhoanca juaj thotë se jemi shumë të hapur për dëgjesa, ata deklaruan publikisht që do ta bojkotonin dhe sot e kanë bojkotuar, dhe unë jam e detyruar që t'i lajmëroj që do të vij në një datë tjetër, kur të ketë kuorumin maxhorancë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë e keni me zë dhe figurë. Për të kuptuar vullnetin e një maxhorance, kanë thënë në komision dhe ka qenë pjesë e një debati, duke filluar nga nënkryetari, zoti Koçi, që unë nuk do të jem prezent dhe nga sekretari e të tjerë, që nuk do të jenë prezentë dhe ju kështu nuk keni kuorumin për ta zhvilluar, në qoftë se ne nuk vijmë. Kjo është thjesht për t'u ditur.

Ne sot po debatojmë. Është gjithçka *online* dhe mund a gjeni në faqen e Kuvendit. Ne për dy javë po debatojmë modelin e menaxhimit të Butrintit, pra dhënien e Butrintit te privati. Nuk po debatojmë as vlerat, as gërmimet, as çfarë është gjetur aty, as nuk jemi arkeologë, a nuk pretendojmë të jemi arkeologë. Ne po debatojmë modelin e menaxhimit dhe këtë marrëveshje që e japim te privati.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ju lutem!

Blerina Gjylameti – Meqenëse unë jam edhe anëtare e Komisionit të Medies dhe të Arsimit, më duhet ta sqaroj dhe të them si qëndron e vërteta.

Seanca e sotme dëgjimore nuk është anuluar nga kolegët e maxhorancës, por për arsye shëndetësore të kryetares së komisionit, zonjës Aça, është shtyrë në një moment të dytë. Në këtë aspekt, unë nuk e di se si mund të thuhet të pavërteta kaq kollaj, ndërkohë, në anën tjetër, profesorët e nderuar që ju përmendët, zonja Zhupa, kanë qenë në këtë komision, si komision përgjegjës, ku ju së bashku me ne i kemi dëgjuar të gjitha pretendimet apo problematikat që ngritën apo edhe sugjerimet që kishim.

Më duket tërësisht e pavend që të thoni gjëra kaq të pavërteta, sy për sy e ballë për ballë.

Eduard Shalsi – Do ta ndërpresin debatin tani. Ju e thatë një opinion. Qëndrimet janë të qarta.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Elva Margariti – Faleminderit!

Në seancën e mëparshme iu përgjigjëm të gjitha pyjeve, të cilat lindën në një seancë para saj dhe atë çfarë pamë, në përfundim të të gjithë *komunikimit live* dhe shënimeve që u morën, pyetjet ishin përsëritëse.

Unë do të preferoja, nëse ju do të ishit dakord, të bëja një përmbledhje që ezauron tërësisht të gjithë konceptin.

Ato çfarë u ngritën si shqetësime në të gjitha komisionet, ose që u artikuluan në formë pyetjesh ose marrje informacionesh, mbi të gjitha, kanë qenë, nëse Butrinti do të vazhdojë të jetë pronë e shtetit nëpërmjet këtij modeli menaxhimi, patjetër që Butrinti do të vazhdojë të jetë pronë e shtetit.

Ai do të administrohet nga një fondacion i posaçëm, që është i themeluar nga shteti shqiptar në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Gjatë dekadës së fundit ky partner strategjik ka kryer një numër tejet të madh investimesh. Është një nga partnerët kryesorë në fushën e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, ka një portofol në këto 10 vjetët e fundit me mbi 50 milionë dollarë, ku janë ngritur njëkohësisht edhe forma të tjera menaxhimi, si ato TID dhe BID, sidomos në këto shtet e trashëgimisë kulturore. Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit nuk është një fondacion i huaj, është një fondacion shqiptar. Edhe kjo ka qenë një tjetër nga pikëpyetjet ose nga kërkesat për informacion të marra gjatë gjithë ditëve të shumta të komisioneve.

Ministria e Kulturës dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim janë bashkërisht në një fondacion të posaçëm, i cili është regjistruar sipas ligjit të OJF-ve të shtetit shqiptar.

Ministria e kulturës vazhdon dhe mbaj tagrin e të gjithë monitorimit të sitit, i përgjigjet ligjit, sipas kuadrit ligjor, dhe vetë fonacioni nuk ka asnjë precedent ose nuk ka asnjë dalje jashtë kornizave ligjore, i përgjigjet ligjit shqiptar dhe, mbi të gjitha, vetë Ministria e Kulturës, me kalimin e kësaj marrëveshjeje administrimi, ngre qendër monitorimi të posaçme pranë ministrisë për të kontrolluar aktivitetin e fondacionit.

Kjo marrëveshje administrimi nuk parashikon asnjë kalim apo tjetërsim prone. Pra, nuk është se kemi kalimin e pronës drejt fonacionit. Ky ka qenë një tjetër hamendësim ose pikëpyetje. Në krye të fondacionit ekziston bordi. Bordi është i përbërë nga 5 anëtarë, dy janë përfaqësues të ministrisë së Kulturës, dy janë përfaqësues të partnerit dhe një ekspert i pestë është eksperti ndërkombëtar, Riçard Hodges.

Aktualisht, kemi një drejtor ekzekutiv, i regjistruar në gjykatë për periudhën transitorë deri në miratimin e ligjit në parlament dhe kalimin në administrim drejt fondacionit. Më pas, në vijim fondacioni do të hapë një *call* ndërkombëtar për drejtorin ekzekutiv të përhershëm të fondacionit.

Të gjithë anëtarët e bordit, ashtu si edhe drejtori ekzekutiv aktual, drejtori transitor, nuk marrin asnjë pagesë nga fondacioni. Ndërkohë, të dy partnerët vendosin në arkën e Butrintit për të çuar përpara objektivat e planit të biznesit dhe të planit të menaxhimit; të dyja palët vendosin aspekte financiare: në këtë rast Ministria e Kulturës kasën e Butrintit, rreth 2 milionë dollarë të mbledhur në gati 10 vjet, ndërsa partneri vjen me një marrëveshje granti me Ministrinë e Kulturës për 5 milionë dollarë.

Ndërkohë, çdo qindarkë, që do të mblidhet në vazhdimësi në arkën e Butrintit, vazhdon dhe mbetet në Butrint. Kjo formë menaxhimi i përgjigjet ligjit të vitit 2018 për trashëgiminë dhe muzetë. Janë marrë parasysh modele të ndryshme si Stonehenge, si qyteti romak i Pompeit, modele italiane përgjithësisht në zonën e Torinos. Kemi muzeun e antikitetëve egjiptianë të Torinos ose fondacionin muze të Torinos.

Plani i ri i menaxhimit është i mbështetur edhe në planet e mëparshme dhe është objektivi ynë të ecim përpara me vizionin 2030, jo vetëm si të gjitha nismat e qeverisë Shqiptare, por në të gjithë botën, të gjitha konventat dhe vizionet, planet në këtë moment hartohen me vizionin 2030.

Çdo investim ose çdo aset që i shtohet Butrintit, në këtë rast e kam fjalën për qendrën e vizitorëve, që do të jetë një nga pikat kryesore me të cilën do të fillojmë përmirësimin e të gjithë standardit të Parkut Kombëtar të Butrintit, do t'i mbetet shetit shqiptar.

Ministria e Kulturës ka tagrin në çdo moment, nëse shikon që nuk realizohen objektivat ose nuk arrijmë standarde, të cilat janë parashikuar në planmenaxhimin dhe planbiznesin, ka të gjithë tagrin në marrëveshje që ta ndërpresë këtë marrëveshje.

Kjo është një marrëveshje 10-vjeçare. Nuk ka një rinovim automatik. Në momentin e rinovimit të dyja palët të ulen sërish për të bërë negocimin e të gjitha kushteve të marrëveshjes. Do të kemi deri në atë kohë një eksperiencë shumë të gjatë.

Në rastin e Butrintit, meqë është një pasuri botërore e UNESCO-s, ligji shqiptar i kërkon Ministrisë së Kulturës që këtë marrëveshje ta kalojë në parlament. Kështu, edhe në momentin e rinovimit, nëse palët do të bien dakord për të nënshkruar sërish një marrëveshje

administrimi, do të kalojmë në të njëjtin proces negocimi dhe marrje mendimesh midis nesh deri në miratimin në parlament.

Bashkë me këtë marrëveshje administrimi kemi sjellë edhe protokollin e bashkëpunimit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit me Institutin e Arkeologjisë, e cila vjen jo vetëm si kërkesë e kohës, por edhe për t'i dhënë prioritet fushës së arkeologjisë, që, patjetër, është një nga sektorët që Ministria e Kulturës ka misionin për ta mbrojtur, për ta promovuar dhe për t'ua trashëguar brezave. Pra, nuk kemi hartuar vetëm protokollin e bashkëpunimit, por kemi dakordësuar edhe ngritjen e Butrinti Research Group, së bashku me ekspertët shqiptarë. Instituti i Arkeologjisë ka të gjithë përparësinë mbi kërkimet shkencore në sit dhe, mbi të gjitha, çdo iter i marrjes së lejeve për gërmime, restaurime ose për kërkime shkencore vazhdon dhe ndjek të njëjtin iter si më parë, pra duke marrë miratimet pranë Ministrisë së Kulturës.

Unë ju falënderoj, në fakt, për prezencën e studentëve sot, sepse, në fund të fundit, i gjithë misioni i vetë Institutit të Arkeologjisë është të ngrejë brezat e rinj! Vetë Butrinti është një sit, i cili ka premisa për të përgatitur studentë të kualifikuar dhe jo vetëm shqiptarë, pasi synimi ynë është të ngremë një pol rajonal në Butrint, sepse e ka këtë lloj kapaciteti.

Kështu që me këtë marrëveshje, me vizionin e planit të menaxhimit dhe me fondet e parashikuara edhe në planin e biznesit, jemi besoj patjetër në rrugën e duhur.

Çdo vit Fondacioni do të raportojë si pranë ministrisë, ashtu edhe pranë UNESCO-s. Kështu që kjo është një sfidë që fillon në një sit, në një pasuri botërore, që është patjetër jo vetëm për ne një mbështetje, duke pasur parasysh rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, por është patjetër edhe një model që, duke e filluar në standardin më të lartë, çon përpara idenë se duke ecur përpara mirë me këtë model, ta pilotojmë dhe ta replikojmë edhe në site të tjera.

Këto janë në përgjithësi të gjitha pikat që janë diskutuar edhe në komisionet e mëparshme, pa ju kthyer pyetje mbi pyetje.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Margariti!

Atëherë, kush nga kolegët ka komente, qëndrime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, fillimisht zonja Zhupa. Më pas zonja Denaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju lutesha të ishim konçizë, pasi është seanca e tretë ku ne japim qëndrime, bëjmë pyetje dhe marrim përgjigje.

Atëherë, zonja Zhupa, fjala për ju.

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar zonja drejtuese!

Realisht nuk kam pyetje.

Ç'është e drejta, kam ezauruar mbi 130 pyetje, shumica pa përgjigje. Edhe pyetjet, kur drejtoheshin, ishin në interes të opinionit publik dhe jo në interesin tim personal, sepse realisht unë i kisha shumë të qarta duke lexuar të gjitha dokumentet e Fondacionit dhe të marrëveshjes. Por dua të them disa gjëra, duke iu drejtuar fillimisht kolegëve, të cilët do të kenë mundësi që edhe ta votojnë, por edhe duke përfituar nga prezenca e ministres.

Së pari, më vjen keq që ndodhemi këtu në një datë, në datën 17 maj, ku marrim vendim për të kaluar në një model hibrid te privati Butrintin për 10 vjet, në një formë koncesionare, jo vetëm falas, por edhe me një bonus 2 milionë dollarë, që gjenden në arkat ekzistuese të Butrintit.

Sot është dita kur 2 vjet më parë ju shkatërruat Teatrin Kombëtar, një vendim i cili u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese e këtij vendi, por pasojat e tij nuk u zhbënë dot, sepse Teatri ishte shembur.

Ju doni përsëri sot të kaloni një ligj, i cili do të atakohet në Gjykatën Kushtetuese, në qoftë se do ta kaloni kështu siç është, sepse është një model në kundërshtim me atë që thotë Konventa e Parisit e vitit 1972, edhe pse ju e keni bërë si model ligjor, pasi në vitin 2018 keni miratuar një ligj po me mbështetjen e të njëjtit fondacion, ku edhe ai ka nenet e veta antikushtetuese dhe antikonvente.

Për sa i përket krahasimit, që bëri zonja ministre dhe që e ka thënë shpesh, me muzeun *Egizio di Torino*, pra me Muzeun Egjiptian të Torinos, nuk është e njëjta gjë, por totalisht një gjë tjetër. Madje për këtë dua ta sqaroj opinionin publik, se unë personalisht në qëndrimet që kam mbajtur, dhe këtu flas totalisht në emrin tim personal, nuk kam asnjë problem në qoftë se dikush dëshiron të dhurojë për Butrintin, nuk kam asnjë problem në qoftë se një privat do të japë donacion për Butrintin dhe nuk kam asnjë problem në qoftë se një privat përfshihet në një bord shtetëror për të monitoruar paratë që ka dhënë vetë.

Problemi im është modeli juaj që ia jepni në mënyrë të plotë administrimin privatit dhe shteti është minoritar, siç nuk ndodh në asnjë vend të botës, ku sipas statutit të Fondacionit ju jeni dy anëtarë dhe fondacioni është tre anëtarë.

Siç nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër, dhe këtu do t'ju marr shembullin që ju sapo e përmendët dhe pata fatin që sapo e përmendët edhe vetë të njëjtin muze, për t'ju thënë se si administrohet ai muze.

E para, të gjithë themeluesit janë *ex officio*, që do të thotë se janë *non in proprio, ma nella sua qualità*, pra nuk janë si emra të përveçëm, por janë në cilësitë e tyre si përfaqësues, gjë e cila nuk ndodh në statutin tuaj dhe në fondacionin tuaj, sepse, përveç jush, që jeni ministre (ku edhe aty nuk jeni si ministre, por jeni si emër), emrat e tjerë janë emra privatë, juristë privatë, që nuk përfaqësojnë asgjë në organet shtetërore.

E dyta, dhe këtu i referohem përsëri muzeut të Torinos, atij që iu referuat edhe ju, raporti në fondacion është 4 me 2, ku 4 janë përfaqësues shtetërorë dhe 2 janë përfaqësues privatë. Ndërsa raporti në Shqipëri është 3 me 2, ku 3 janë përfaqësues privatë dhe 2 janë përfaqësues shtetërorë.

Në raportin e atij që ju merrni shembull dhe thoni se është shembull i njëjtë, do t'ju them se cilët janë përfaqësuesit: është ministri i Kulturës, prapë si *ex officio*, kushdo qoftë ministri i Kulturës; është presidenti i rajonit të Piemontes, prapë *nella sua qualità*; është presidenti i provincës së Torinos; është kryetari i bashkisë së Torinos, pra katër autoritete shtetërore, me pozicion të qartë shtetëror dhe për interes publik (pra, kryetar bashkie, jo njerëz që i cakton ministria, që është ky individ), dhe ka dy përfaqësues privatë, që janë presidenti i kompanisë *San Paolo* dhe presidenti i Fondacionit *Casa di Risparmio di Torino*.

Jua u solla, sepse keni thënë shumë herë se ky është modeli dhe, për ta sqaruar opinionin publik se ky nuk është modeli, sepse nuk ka model në botë, madje jua them me garanci të plota, si modeli shqiptar. Modeli shqiptar është i vetmi që i jep privatit shumicën dhe shtetit pakicën, ku shteti është aty thjesht si për të na hedhur hi syve që unë jam pjesëtar, se në fund të ditës, është e vërtetë, që ti nuk e shet Butrintin, se nuk ke mundësi, nuk ekziston mundësia që ti të shesësh pasurinë kulturore, por ti e jep atë në mënyrë të plotë dhe në një menaxhim totalisht të varur nga privati për 10 vjet. Sigurisht, kjo gjë çon edhe, siç e thotë në statut, pra dominimi i privatit çon në heqjen e institucioneve shtetërore, të cilat bëjnë monitorimin e fondeve publike, dhe në rastin konkret të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Madje, siç e ka vetë statuti i Fondacionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ndërpret marrëdhëniet me Butrintin, sepse nuk i monitoron dot paratë e privatit, gjë të cilën e thotë vetë në nenin 26/5: “Këto nuk konsiderohen më fonde publike dhe nuk janë objekt i Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Këto jua solla si detaje për të kuptuar se sa të pavërteta janë thënë këto kohë në lidhje me “do ta ketë prapë shteti, e ka shteti?”. Shteti e ka aktualisht, ekziston një bord me shtatë anëtarë, i ngjashëm me bordin e Torinos, por ndryshimi është që nuk ka privat dhe janë të gjithë *ex officio*, si: agjencia e turizmit, bashkia e Torinos e të tjera.

Ju keni eliminuar totalisht pushtetin lokal, keni eliminuar totalisht përfaqësuesit e pushtetit lokal, që janë edhe përfaqësuesit që kanë më shumë detyrime edhe për komunitetin, ndërkohë flisni këtu, po edhe nëpër komisione, se ju keni fokus kryesor komunitetin, se unë si deputete e Sarandës duhet të jem e lumtur e të tjera e të tjera. Madje, bashkinë që ka në fokus kryesor pikërisht komunitetin ju nuk e keni përfshirë fare, ndërkohë që të gjitha fondacionet në të gjitha vendet e botës kanë një përfaqësues të pushtetit lokal brenda këtyre fondacioneve.

Tjetër, zonja Ministre, modeli që ju na sillni është një model, i cili realisht, jua garantoj që unë do të jem promotore që ta bëj këtë dhe të mos e lë të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, pra ky ligj, në qoftë se e miratoni kështu siç e keni, do t’ju rrëzohet, siç u rrëzua edhe vendimmarrja për Teatrin.

Tani, ftoj anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, si komision përgjegjës, të reflektojnë në tagrin e tyre si deputetë, si përfaqësues dhe të mos nisen nga një vendimmarrje thjesht politike, sepse këtë e ka sjellë qeveria dhe kështu e do ajo, por të reflektojnë sepse kjo nuk është mënyra se si jepet pasuria kombëtare, trashëgimia kulturore, në duart e një privati.

Sot mund të kemi të gjithë dëshirën e mirë për ta kuptuar se ai privati mund të jetë shumë prestigjioz, por ju kujtoj atë që e kemi përmendur edhe më parë në këtë komision: studiues të nderuar si ata që janë, po them, themeluesit e atyre që janë gjetur në Butrint, si Ugolini, mbushën valixhet dhe morën me vete ato që u zbuluan atje.

Kështu që asnjë nuk na e heq dyshimin që, sado i mirë të jetë privati, është thjesht privat dhe është shteti që ka detyrimin, qoftë edhe sipas Konventës së Parisit të vitit 1972, që duhet të jetë garant. Madje, modeli i të gjitha vendeve të botës është që në çdo fondacion, sado pjesëmarrje private të ketë, përsëri është shteti që ka shumicën. Ndërkohë, në Shqipëri jo vetëm nuk e ka shumicën, por edhe kryesimin e bordit e ka vetëm 2 vjet, pastaj kryesimin e bordit mund ta marrë secili nga anëtarët e tjerë pjesëmarrës në këtë fondacion.

Jua them me përgjegjësi të plotë që vetëm ministrja e Kulturës është si ministre e Kulturës, por edhe këtu me emër, ndërkohë që asnjë tjetër nuk ka një prezantim për çfarë përfaqëson për shtetin shqiptar, në momentin që është përfaqësues i shtetit shqiptar. Se ne nuk

mund të marrim një individ privat dhe të themi që përfaqëson shtetin shqiptar. Në këtë moment ai është thjesht një individ privat, pra merren pozicionet siç i ka edhe Muzeu i Torinos, që ju e keni përmendur pa fund, pa fund në të gjitha komisionet, e përmendët edhe sot këtu.

Të nderuar kolegë, për ta mbyllur fjalën time, ju lutem, mos t'ia bëni këtë gjë trashëgimisë kulturore sot në dyvjetorin e shembjes së Teatrit Kombëtar, një vendimmarrje e cila u vërtetua se ishte edhe ajo antikushtetuese. Mos bëni një vendimmarrje tjetër antikushtetuese, në dëm të trashëgimisë kulturore!

Butrinti është i përbashkët. Butrinti është juaji sa edhe yni, por, mbi të gjitha, është i brezave të ardhshëm të cilëve do t'ua lëmë.

Nuk ekziston në asnjë vend të botës ky model. Ju lutem, mos e votoni!

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Fjalën e ka zonja Denaj.

Do t'ju lutesha, në qoftë se është e mundur, të mos bini në përsëritje.

Anila Denaj – Jo, as e kam parim...

Blerina Gjylameti – Harxhojmë kohë pa fund në përsëritje.

Anila Denaj – ...përsëritjen.

Kam nevojë të falënderoj, së pari, ministren për shpjegimet dhe do t'i kërkoja që në vijim, pavarësisht diskutimeve, të ketë një periodicitet, qoftë nëpërmjet *web-it* të ministrisë apo formave të ndryshme të komunikimit, që të vijohet përgjatë muajve dhe viteve në vijim një informim publik, sepse këtu mungesa e plotë e informimit publik çon gjithmonë në keqinterpretime. E kjo ndoshta do të ishte në të mirën publike, pra të ketë një vijueshmëri komunikimi, siç është bërë këto ditë komisioni dhe ju falënderojmë këtë!

Butrinti është një nga pasuritë kulturore të Shqipërisë dhe, absolutisht, në të mirë të kësaj pasurie publike zhvillimi i saj merr vlerë, prandaj edhe votimi për zhvillimin e një pasurie kulturore jo vetëm arkeologjike, por, mbi të gjitha, historike, kulturore dhe ekonomike merr peshë jo vetëm për zonën, por për të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë, nuk duhet të ngatërrojmë në mënyrë absolute çështjet ekonomike me ato të përfaqësimit. Këtu nuk ka koncesion, por ka një fondacion, i cili është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe është pa qëllim përfitimi, po të flasim për përfitueshmëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mund të bëni çfarëdolloj mimike, zonja Zhupa, por ky është fakt dhe këto janë termat ekonomike, përtej përfaqësimit. Madje, këtë duhet të dëgjojnë shqiptarët, se nuk ka zhvendosje pronësie; pronësia është e Shqipërisë.

Këto janë të vërtetat në dy fjali dhe çfarëdo të thoni, këto të vërteta dot nuk i tjetërsoni. Zhvillimi i Butrintit dhe i të gjithë Jugut të Shqipërisë, edhe në raport me turizmin, është patjetër një produkt që në tre vjetët e ardhshëm nuk e pengoni dot.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Denaj!

Kalojmë në procesin e votimit të projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e parkut kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

E votojmë fillimisht në parim. Kush është pro?

Erion Braçe (*pa mikrofon*) – E kemi votuar një herë në parim...

Blerina Gjylameti – Kush është pro? Kundër? 4 vota kundër. Abstenim? 2 vota abstenim.

Dakord.

Vijojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? 4 vota kundër. Abstenim? Dy vota abstenim.

Neni 2.

(*Deputeti Braçe flet pa mikrofon*): Para se të votojmë nenin 2, unë kam një propozim.

Blerina Gjylameti – Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Siç e thashë edhe javës që shkoi, kur e diskutuam projektligjin në tërësinë e tij, unë nuk kam asgjë me marrëveshjen, me thënë të drejtën, më duket pozitive që ai sit do të menaxhohet në atë mënyrë, ndërkohë që kontesti im vjen për zonën e mbrojtur, për Parkun Kombëtar të Butrintit, që është më i gjerë sesa Parku Arkeologjik i Butrintit.

Është pikërisht parku që është bërë objekt, natyrisht, i interesave, i presionit shumë të madh për t’u ngatërruar edhe me aktivitete të tjera zhvillimore.

Pikërisht për këtë arsye dua që para votimit të nenit 2, poshtë nenit 1, të vihet neni 1/1 që kërkon ose thotë: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave të mbrojtë dhe të garantojë paprekshmërinë e kufijve të Parkut Kombëtar të Butrintit, zonë e mbrojtur, Ramsar”.

Blerina Gjylameti – Zonja Ministre, qëndrimi juaj?

Elva Margariti – Kjo është e shprehur saktësisht në planin e menaxhimit të integruar, ndërkohë që për sa i përket zonës së cilës i referohet zoti Braçe, ajo nuk është pjesë e marrëveshjes së administrimit.

Blerina Gjylameti – Dakord.

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon): Mundem?

Blerina Gjylameti – Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Të mos i ngatërrojmë gjërat. Unë nuk fola për marrëveshjen.

Edhe një herë, fola për një territor që është shumë më i gjerë, pa të cilin Parku Arkeologjik i Butrintit do të jetë vazhdimisht i cenueshëm, do të jetë nën agresion vazhdimisht.

Për të mbrojtur edhe marrëveshjen, për të mbrojtur edhe zonën, peizazhin e zonës, nga i gjithë presioni dhe nga i gjithë interesi i shtuar për të ndërtuar aty për qëllimet e tjera, të cilat janë të ndryshme nga natyra apo nga arkeologjia, po bëj këtë propozim që me ligj qeveria të ngarkohet për të garantuar kufijtë e Parkut Kombëtar të Butrintit, zonë e mbrojtur, Ramsar. Kaq.

Ai qytet antik, pa atë peizazh që ka në këtë zonë të mbrojtur, do të jetë hiçgjë, do të kthehet shumë shpejt nësoj si Amfiteatri i Durrësit.

Blerina Gjylameti – Zonja Margariti, keni ndonjë qëndrim tjetër përveç asaj që thatë?

Jam e bindur se propozimi që bëri zoti Braçe ndoshta do të duhet të jetësohet në një tjetër dokument dhe në një tjetër propozim që vjen nga qeveria, sepse këtu po diskutojmë për marrëveshjen.

Elva Margariti – Këtë doja të specifikoj, në fakt, që marrëveshja e administrimit i përket zonës A3 të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe vetëm për këtë zonë Ministria e Kulturës ka tagrin të lidhë marrëveshje ose të krijojë fondacionin e posaçëm dhe marrëveshjen e administrimit nëpërmjet këtij fondacioni.

Sa për zonat e tjera, aktualisht unë jam informuar po nësoj edhe për pjesën e zonave të mbrojtura dhe për debatin që ka lindur mbi investimet strategjike në zonë. Ato janë jashtë zonës së mbrojtur dhe zonës së mbrojtur Ramsar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Në planin e menaxhimit të integruar, që është po ashtu një vendim të Këshillit të Ministrave, që ka kaluar në korrik të vitit 2020, ne aty kemi miratuar të gjitha detyrimet që ka pala shtet për zonat e mbrojtura dhe kemi përcaktuar në vijim edhe se cilët janë kufijtë e këtyre zonave të mbrojtura.

Ministria e Kulturës në këtë moment është duke lidhur marrëveshjen për zonën A3.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon.)

Zoti Braçe, unë besoj se u ezaurua...

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon): Për sa kohë është propozimi im, patjetër...

Blerina Gjylameti – Patjetër, do ta hedhim në votim.

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon): A ka mundësi të sqaroj unë lidhur me çfarë tha zonja...?

Erion Braçe – Edhe një herë, se çfarë përfshihet në Parkun Kombëtar të Butrintit, në zonën e mbrojtur Ramsar, është shumë e qartë.

Në momentin që qeveria, pa diskutim, e kufizon këtë zonë, jemi te kufijtë që ka përcaktuar qeveria. Në dijeninë time, të paktën në një rast Parku Kombëtar i Butrintit, zonë e mbrojtur, është cenuar dhe kemi qenë prezentë edhe unë, edhe ju.

Çfarë dua të them me këtë? Dua të them se çfarë ndodhi, ndodhi. A ka mundësi tani të mos cenohen më kufijtë e zonës së mbrojtur, Parku i Butrintit?

Këtë po kërkoj, që të mos cenohet më, sepse vërtet themi “interes strategjik”, por kjo strategjia që “shkoj unë, ndërtoj atje një hotel apo ndërtoj unë atje 25 vila” dhe kjo qenka strategjike për Shqipërinë, e kam të vështirë ta pranoj dhe ta mendoj, me thënë të drejtën. E kam shumë të vështirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, zonja Margariti, apo ta hedhim në votim propozimin e zotit Braçe?

Unë besoj se ishte e qartë, se për sa kohë nuk është objekt i kësaj marrëveshjeje, nuk kemi si ta shtojmë në këtë marrëveshje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk lind? Kështu që besoj se do të duhet që si propozim të jetësohet në një moment të dytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Entela Çipa – Faleminderit, zonja drejtuese!

Për sa i takon propozimit, baza ligjore në projektligj është neni 172 i ligjit “Për trashëgiminë”, i cili nuk ka lidhje me propozimin që vjen nga deputeti Braçe.

Pra, është për sa i takon krijimit të fondacioneve të posaçme dhe mbi këtë bazë miratohet marrëveshja. Në këtë rast, do të duhej një bazë tjetër ligjore e cila nuk është në administrim të Ministrisë së Kulturës që të përfshihet për sa i takon territorit të Parkut Kombëtar dhe nuk i përket këtij ligji. Duhet të rishikohet i tëri.

Ndoshta këshilltarët e komisionit mund të japin një opinion më të thelluar ligjor, por nuk është nën administrimin e Ministrisë së Kulturës.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Zonja Margariti...

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon.)

Zoti Braçe!

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon): Nuk e kërkova nga Ministria e Kulturës, nuk e di, a e dëgjuat apo jo? “Ngarkohet Këshilli i Ministrave të mbrojtje dhe të garantojë kufijtë dhe hapësirën e Parkut Kombëtar të Butrintit si zonë e mbrojtur”. Kaq kam kërkuar dhe këtë nuk ia kërkova Ministrisë së Kulturës, por Këshillit të Ministrave që ka marrë vendimin!

Blerina Gjylameti – Atëherë, zoti Braçe, unë besoj se u sqarua ajo se çfarë jeni duke kërkuar, edhe nga ministrja e morëm opinionin. Më pas do të duhet të presim nga Këshilli i Ministrave që pikërisht propozimin tuaj ta përkthejnë në një projektligj tjetër apo edhe në ndryshimet e ligjeve përkatëse.

Atëherë, e hedhim në votim në tërësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, duhet të votojmë nën 2! Kush është pro? Kundër? Abstenim? Vazhdojmë me një?

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Dy vota abstenim.

Vazhdojmë me pikën 2...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për votën? Patjetër, zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Kam një shpjegim personal vote.

Përpara disa vitesh Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF-ja), në bashkëpunim me qeverinë shqiptare apo me Ministrinë e Kulturës, nuk jam shumë në dijëni, por për fondacionin jam i sigurt, ka kontribuar thelbësisht në rikonstruksionin e plotë të ndërtesave në rrugën “Justin Godard” në Sheshin e Flamurit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, qendra historike e Vlorës.

...për sa i përket fasadës, ndërtesave nga jashtë, jo ndërtesave nga brenda, madje pjesërisht nga brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë kompleks dhe në këtë rrugë të vjetër historike, unë posedoj një ndërtesë të vjetër, të cilën e kam në projekt për ta shndërruar në muzeun “Kosova”.

Në këto kushte, për faktin se Fondacioni ka investuar indirekt edhe në këtë ndërtesë që unë posedoj, unë kalova në një pozicion që abstenoj për sa i përket votimit, pra as pro, as kundër, për të shmangur çdo keqkuptim, jo se kam ndryshuar apo kam lëvizur në ato pikëpamjet e mia.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Leskaj!

Faleminderit, zonja Margariti!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë!

Elva Margariti – Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit juve!

Sekretare e Komisionit

Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar administrativ

Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Blerina Gjylameti – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Miratimi i draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të INSTAT-it për vitin 2021 (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Benet Beci dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Eduard Shalsi, Jorida Tabaku, Alfred Rushaj dhe Agron Shehaj.

Blerina Gjylameti – Të nderuar kolegë, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: miratimi i draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të INSTAT për vitin 2021.

Presim disa minuta.

(Largohen të ftuarit.)

Atëherë, kolegë, vijojmë me pjesën e dytë, me draftrezolutën e INSTAT-it, e cila ju është dërguar në adresat tuaja elektronike.

Pas reflektimeve që janë bërë dhe sugjerimeve që ka pasur nga kolegët, kalojmë në votimin e draftit përfundimtar, që do t'i përcillet më tej seancës plenare.

E hedhim në votim projektrezolutën. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Mbledhja e radhës do të jetë nesër në orën 11:00.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e Komisionit

Enslemvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar administrativ

Elvi Prifti